



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister
Zyra për Qeverisje ë Mirë/Kancelarija za Dobro Upravljanje/Office on Good
Governance

**THIRRJE PËR NOMINIME NGA OSHC-TË PËR PËRFAQËSUES TË SHOQËRISË
CIVILE NË KËSHILLIN PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË QEVERTARE PËR
BASHKËPUNIM ME SHOQËRINË CIVILE**

Këshilli për zbatimin e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile është një trupë e krijuar për të siguruar, koordinuar dhe monitoruar zbatimin e Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017 si dhe Planin e Veprimit për zbatimin e kësaj Strategjie 2013 -2015. Këshilli ka 29 anëtarë, 14 përfaqësues të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe 15 përfaqësues të shoqërisë civile. Nga përfaqësuesit e shoqërisë civile, 1 emërohet nga Platforma CiviKos ndërsa 14 të tjerë zgjedhen nga nga vet organizatat e shoqërisë civile.

Për të përzgjedhur përfaqësuesit e shoqërisë civile në Këshill, ftohen OshC-të aktive në Kosovë për të nominuar përfaqësuesit e tyre. Ftesa nuk është e kufizuar vetëm te organizatat anëtare të Platformës CiviKos.

Për të nominuar një kandidat/e, OSHC-ja duhet të dorëzojë dokumentet e mëposhtme:

1. Formularin për Nominim, i nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar i OshC-së;
2. Një biografi të kandidatit/es të nominuar;
3. Certifikatën e regjistrimit të OJQ-së ose një dokument që dëshmon aktivitetin e rrjetit jo-formal;

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen drejtëpërdrejtë ose me postë në adresën *Platforma CiviKos, Rr. Fazli Grajqevci 4/a, 10000 Prishtinë, jo më vonë se 25 gusht 2014.*

OshC-të të cilat bëjnë nominime dhe kandidatët e nominuar duhet të plotësojnë kriteret bazë, siç janë të përcaktuara në Formularin për Nominim. Pas përfundimit të nominimit, paneli i përbërë nga një përfaqësues i Sekretariatit të Platformës CiviKos, një anëtar i Bordit të CiviKos-it dhe një përfaqësues i Zyrës për Qeverisje të Mirë të Zyres së Kryeministrit (ZQM/ZKM) do të verifikojë nëse kandidatët e nominuar i plotësojnë kriteret e kërkuara. Të gjithë kandidatët që konstatohet që i plotësojnë kriteret e kërkuara do të përfshihen në listën përfundimtare për votim.

Menjëherë pas përpilimit të listës përfundimtare për votim, Platforma CiviKos do të njoftojë publikisht për hapjen e procesit të votimit dhe do të publikojë në faqen e vet të internetit fletëvotimin zyrtar. Të gjitha OShC-të e regjistruara mund të votojnë për kandidatët e tyre të preferuar brenda një afati prej 5 ditësh nga hapja e procesit të votimit. Secila organizatë mund të votojë për 14 kandidatë nga lista e kandidatëve të përfshirë në fletëvotim.

Votuesit mund të hedhin votën e tyre me e-mail, postë të rregullt ose personalisht në zyrën e CiviKos. Në rastin e votimit me e-mail ose me postë të rregullt, organizata që voton duhet të dërgojë fletëvotimin e plotësuar dhe kopjen e certifikatës së regjistrimit të OJQ-së. Në rastin e votimit në zyrën e CiviKos, organizatat duhet të dorëzojnë kopjen e certifikatës së regjistrimit të OJQ-së dhe të hedhin fletëvotimin e tyre në kutinë e votimit në zyrën e CiviKos. Votimi anonim mund të bëhet vetëm nëpërmjet votimit në zyrën e CiviKos-it.

Procesi i votimit do të organizohet dhe menaxhohet nga një komision i përbërë nga personeli i Sekretariatit të Platformës CiviKos, që caktohet nga Drejtori Ekzekutiv i CiviKos. Pas përfundimit të afatit për votim, komisioni i Sekretariatit të Platformës CiviKos do të numërojë fletëvotimet për të përcaktuar se cili(a) kandidat(e) ka marrë numrin më të madh të votave. 14 kandidatët që marrin më së shumti vota zgjedhen si përfaqësues të OShC-ve në Këshill. Nëse dy kandidatë marrin numrin e barabartë të votave, vendi si përfaqësues i OShC-ve në Këshill do të përcaktohet me short në mes tyre.

Për të mbikëqyrur procesin e numërimit të votave, Platforma CiviKos do të ftojë në cilësinë e vëzhguesëve të gjitha OShC-të që kanë bërë nominime, rrjetet aktive të shoqërisë civile, përfaqësuesit e Departamentit për Regjistrim të OJQ-ve dhe përfaqësuesit e ZQM/ZKM.

Për të reflektuar diversitetin shoqëror dhe të shoqërisë civile në Kosovë, inkurajohet nominimi i grave, anëtarëve të komuniteteve jo-shumicë dhe grupeve të nënpërfaqësuar.

Formulari për Nominim mund të shkarkohet nga faqja e internetit www.civikos.net

Për çfarëdo pyetje rreth këtij procesi të përzgjedhjes, kontaktoni Platformën CiviKos nëpërmjet e-mailit info@civikos.net ose numrit të telefonit 038 224 904.